



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS

Nr. 486 / Prot.
/k

Durrës, më 17.04.2019

N J O F T I M

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR EMËRIMIN NË
POZICIONIN E PUNËS SEKRETAR**

Bazuar në ligjin nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhërit nr 27 datë 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për “Strukturën organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës”, me qëllim plotësimin e vendeve vakante që ekzistojnë në strukturën e institucionit në pozicionin 2 (dy) sekretar, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës:

N J O F T O N

1. Fillimin e procedurës për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **sekretar**, pranë Prokurorëve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
2. Referuar neneve 74, 75 dhe 76 të ligjit nr 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, kandidatët e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për t’u pranuar në shërbimin civil, duhet të plotësojnë dhe kritere të veçanta, të jenë diplomuar “Jurist”, si dhe të ketë të paktën një vit praktikë profesionale ose cdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me Prokurorinë.
Kandidatët për pozicionin e lirë të punës “sekretar” duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Kërkesë me shkrim,
 - b. Kopje të dokumentit të identifikimit,
 - c. Curriculum Vitae,
 - d. Diplomë universitare të nivelit “Bachelor” dhe “Master” në Fakultetin Juridik (të noterizuara).
 - e. Dokument që vërteton praktikën profesionale.
 - f. Dëshmi kualifikimi apo specializimesh (nëse ka),
 - g. Vlerësime të punës nga punëdhënësi të mëparshëm,
 - h. Vërtetim për gjendjen gjyqësore,
 - i. Raport mjeko-ligjor,
 - j. Çertifikatë të gjuhës së huaj (nëse ka).
 - k. Dëshmi kompjuteri.
3. Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet brenda datës 02.05.2019 në K/Sekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NE PROKURORINË
PRANË GJYKATES SË RRETHIT GJYQËSOR DURRËS**